

Kërkesë – Aplikim

Lënda: Kërkohej fillimi i procedurave administrative për realizimin e një projekt-investimi strategjik në fushën e Turizmit.

Drejtuar: Z. Arben AHMETAJ
Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Z. Genti BEQIRI
Direktor Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve

Për Dijeni: Z. Edi RAMA
Kryeministër, në rolin e Kryetarit të Komitetit të Investimeve Strategjike

Tiranë, 25.11.2015

Të nderuar Zotërinj,

Ashtu sic jeni në dijeni, prej mëse një viti shoqëria "Mabetex" group ka shprehur interesin e saj për realizimin e një investimi të madh në fushën e turizmit, në bregdetin/gjirin e Divjakës, në zonën ndërmjet dy lumenjve Shkumbin dhe Seman.

Për këtë qëllim, shoqëria "Mabetex" group ka ndërmarrë disa iniciativa dhe ka kryer paraprakisht disa studime dhe ka hartuar disa projekt-ide fillestare, të cilat do të mund t'ju shërbejnë për të kuptuar më qartë llojin, vecantinë dhe rëndësinë e investimit, i cili kërkohet të realizohet. Në respekt të traditës sonë, shoqëria Mabetex group po bashkëpunon me studiot dhe konsulentë ndërkombëtare më serioze dhe prestigjioze për kryerjen e studimit të fizibilitetit dhe masterplanit të ndërtimit.

Në vijim të takimeve paraprake si me përfaqësues të zyrës së Kryeministrit, ashtu edhe të Ministrisë së Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shoqëria Mabetex group me datë 03.11.2015 depozitoi pranë Qeverisë Shqiptare zyrtarisht "Letrën e Interesit", duke shprehur kështu parimisht dëshirën për fillimin e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe shoqërisë Mabetex group, për realizimin e këtij projekti investues në fushën e turizmit.

Nga ana e saj, zyra e Kryeministrit duke mirëpritur parimisht realizimin e projektit investues të shoqërisë Mabetex group, si dhe duke shprehur gjithashtu gatishmërinë e saj për të mbështetur iniciativën tonë, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe nënligjore, në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, na ftoi të paraqesim kërkesën zyrtare pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Turizmit dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, për fillimin dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore dhe administrative.



mabetex group
Via Cottari 7, CH-6900 Lugana-Paraniso

Tel. +31 (0)91 993 01 01
Fax +31 (0)91 993 06 36

info@mabetex.com
www.mabetex.com



Nisur nga fakti se studimet paraprake të lartpërmendura aktualisht janë në një fazë të avancuar, dhe me dëshirën e mirë që puna për realizimin e këtij projekt-investimi të rëndësishëm të fillojë në një kohë sa më të shkurtër të mundshme,...

...në zbatim të Ligjit nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", Ju paraqesim zyrtarisht kërkesën tonë, duke kërkuar njëkohësisht nga ana Juaj për:

1. Fillimin e procedurave të nevojshme ligjore dhe administrative për shqyrtimin dhe dhënien e statusit Investim Strategjik Procedurë e Vecantë përsa i përket projektit investues të shoqërisë Mabetex group, në fushën e Turizmit, në bregdetin/gjirin e Divjakës;
2. Shqyrtimin dhe dhënien e të gjitha incentivave dhe mbështetjeve të nevojshme ligjore të parashikuara në Kreun 6 "Investimet në Turizëm", të Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", dhe në Kreun VII "Masa Mbështetëse", të Ligjit nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", nga ana e Qeverisë Shqiptare për realizimin e projektit investues;
3. Aplikimin me përpikmëri të të gjitha procedurave lehtësuese dhe përsheptuese administrative, të parashikuara nga Ligji nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" për shqyrtimin, vlerësimin, dhe miratimin e projektit investues të shoqërisë Mabetex group, si dhe lëshimin e të gjitha licencave/lejeve/autorizimeve të nevojshme për fillimin e punimeve në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

MABETEX GROUP

Mabetex Group që prej themelimit të saj, është një kompani lider në dizajn, ndërtim dhe projektim të objekteve administrative dhe objekteve qeveritare, si dhe në realizimin e komplekseve turistike, hoteleri, shëndetësi dhe objekte rezidenciale.

Mabetex Group ka realizuar me sukses projekte të rëndësishme në mbarë botën në tre dekadat e fundit, të cilat përfshijnë konkretizimin e komplekseve të rëndësishme ndërtimore, sic është renovimi i Kremlinit në Rusi, ndërtimi i pallatit Presidential në Astana, kryeqyteti i ri i Kazakistanit dhe shumë projekte të tjera të rëndësishme në Republikën e Jakutisë, Azinë juglindore, Europë dhe Ballkan.

Veprimtaria e Mabetex Group shtrihet dhe përfshin gjithashtu biznese të ndryshëm të diversifikuar në industri dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm si Institucione Financiare, Hoteleri Luksoze, Fabrika Prodhimi të Ndryshme, të gjitha këto pjesë e strategjisë dhe vizionit afatgjatë të Mabetex Group, si Konglomerati i parë mbarë Shqiptar që investon në të ardhmen tonë.


Në Republikën e Kazakistanit, në Kryeqytetin e ri të Astana, kemi realizuar me sukses projektimin dhe ndërtimin e pjesës më të madhe të objekteve të reja qeveritare duke përfshirë objekte të ndryshme ministrorë, të gjitha këto pjesë e një prej sipërmarrjeve më komplekse organizative dhe inxhinierike të historisë botërore, që prej marrjes së vendimit në vitin 1997, për rialokimin e kryeqytetit të Kazakistanit prej Almatit në Astana.



mabetex group
Via Caritari 7, CH-6900 Lugano-Pradolfo

Tel. +41 (0)91 985 01 01
Fax +41 (0)91 993 06 36

info@mabetex.com
www.mabetex.com



Së fundmi, kemi projektuar dhe ndërtuar Teatrin Kombëtar të operas dhe baletit në Astana, sallën e koncerteve në Astana, hotele të ndryshme, objekte sportive që përfshijnë Velodrome, Spitalin Kardiologjik, stadiumin kombëtar të Hockey dhe fshatin "Saranda" (e cila përfshin një kompleks shumë luksoz vilash dhe pallate banimi).

Një punë e përmasave të mëdha ka nisur në Astana Expo 2017, ku Mabetex Group si lider pranë partnerëve të saj, është duke projektuar dhe ndërtuar një pjesë të madhe të EXPO, e cila konsiderohet si projekt i një rëndësie të vecantë për Republikën e Kazakistanit, si për të pasqyruar sa më denjësisht kryeqytetin e ri në një ngjarje të njohur globalisht, ashtu edhe për të prezentuar njëkohësisht të ardhmen e sektorit të Industrisë Energjetike. Nisur nga ky zgjedhim i qytetit Astana, Mabetex Group tani ka filluar punën për ndërtimin e Aeroportit të ri Ndërkombëtar.

Veprimtaria e Mabetex Group shtrihet gjithashtu në Europë, ku mund të përmendim ndër të tjera ndërtimin e ambasadave të Republikës së Kazakistanit në Gjenevë dhe Paris, në Lugano Hotelin luksoz dhe me pesë yje 'Swiss Diamond', Vila të shumta Luksoze në Spanjë dhe në Kosovë, renovimet e objekteve qeveritare, ndërtimin e qendrave administrative, hoteleve, etj. Aktualisht, pranë Mabetex Group punojnë më shumë se 10,000 punëtorë të përhershëm, dhe ky numër arrin deri në 14,000 punonjës sezonalë përgjatë periudhës vjetore me intensitet të lartë të ndërtimit.

ILUSTRIMI I PROJEKTIT INVESTUES

Duke patur parasysh bukuritë natyrore të vendit Tonë, që po shpallet në mënyrë konstante si një nga destinacionet kryesore turistike në botë,...
...duke konstatuar mungesën e një resorti të madh turistik që do të bënte të mundur përfshirjen e Shqipërisë në hartën e turizmit cilësor botëror,...
...si dhe të nxitur nga përpjekjet e vazhdueshme dhe thelbësore të Qeverisë Shqiptare në krijimin e një klime të mirë biznesi dhe sistemi të qendrueshëm rregullash që padyshim tërheqin vëmendjen e investitorëve të mëdhenj dhe i garantojnë ata për sigurinë e biznesit dhe të drejtave të lidhura me të,...
...ne vendosëm dhe jemi të interesuar të investojmë në ndërtimin e një kompleksi të madh turistik në zonën e bregdetit/gjirit të Divjakës, e cila është një zonë me bukuri të rralla natyrore, por që dora e njeriut fatkeqësisht është duke përshpejtuar degradimin e saj mjedisor.

Ky projekt investimi konsiderohet i një rëndësie të vecantë nga ana e kompanisë sonë "Mabetex" group, dhe për këtë arsye jemi të gatshëm të investojmë sa është e nevojshme për realizimin e këtij projekti ambicioz, duke garantuar paraprakisht një buxhet financiar të lartë për realizimin e këtij projekti.

Ky projekt investues do të sjellë risi teknologjike dhe madhësi arkitekturore, të shoqëruara dhe ndërthurura këto me një impakt dhe përkujdesje jashtëzakonisht të kujdeshme dhe miqësore për ruajtjen, konservimin dhe përmirësimin mjedisor.

Investimi në fjalë synon të valorizojë dhe përmirësojë mjedisin, të ruajë florën dhe faunën, duke kontribuar cilësisht në drejtimin në të cilin po ecën qeveria në atë zonë, të ndalojë degradimin e



mabetex group


Via Castron 7, CH-6900 Lugano-Paradiso

Tel +41 (0)91 993 01 01

Fax +41 (0)91 993 06 35

info@mabetex.com

www.mabetex.com



dëtit, brigjeve, pyjeve, lumenjve, lagunës, të përbësojë mijëra njerëz, të ofrojë stimuj zhvillimi për një zonë me traditë të shkëlqyer bujqësie, të krijojë një sistem ekonomik të vetëmjaftueshëm, të përmirësojë imazhin e vendit, të sjellë të ardhura për financat publike, nëpërmjet një turizmi gjithë vitin, duke alternuar turizmin masiv, me atë elitare, kulturor, mjedisor, agroturizmin, etj.

Qëllimi ynë do të jetë që, duke konservuar dhe valorizuar bukuritë natyrore, në përputhje të plotë me dokumentat ndërkombëtare, ta bëjmë zonën një pikë tërheqëse edhe për investitorë të tjerë të përmasave të mëdha, duke joshur dhe emra të mëdhenj të botës financiare, të biznesit, etj, për të pushuar aty, diçka që do të kishte efekte shumëfishuese pozitive ekonomike, financiare, në imazh, etj.

Më poshtë Ju paraqesim një përshkrim të përgjithshëm në formë tabelare të projekt idesë së këtij investimi:

	Objektet	Përshkrimi i shkurtër
1	Golf Klub	Fusha e Golfit, Klubi i Golfit, restorante, butik
2	Fshati Elitarë 1	Vila luksoze dhe vila dyshe me sipërfaqe 400m ² , 600m ² , 1200m ² dhe 1500m ²
3	Fshati Elitarë 2	Vila dhe Apartamente luksoze dhe sipërfaqe afaniste të dedikuara për tishatin elitare
4	Mole/Pista Detare	Pista Detare me përmbajtje të hapësirave komerciale, bare, restorane, etj.
5	Qendra tregtare, SPA Ëellness	Qendra e wellnessit e jashtme dhe e brendshme e lidhur me strukturat e hoteleve
6	ApertHotel	Përfshijnë butiqe, pishina të brendshme dhe të jashtme, salla të konferencës etj. Të gjitha strukturat janë të lidhura me qendrën tregtare/Shopping.
7	Hotel Luksoz Elitarë, 5 YJE	Hotel luksoz me 5 yje do të ketë të gjitha hapsirat e nevojshme për tu kategorizuar si hotel me 5 yje, me dhoma, apartamente dhe suite luksoze si dhe bungalo. Pishinën e brendshme dhe të jashtme, restorane dhe salla të konferencës, shërbimet shëndetësore, parking të jashtëm dhe të brendshëm, terrenet sportive dhe hapsira të jashtme të gjelbra.
8	Hotel Familjarë	Hotel Familjar me pishina të jashtme dhe të brendshme, atraksione tjera ujore.
9	Hotel Manna/SPA	Hotel Luksoz pranë portit me SPA Ëellness të brendshëm dhe të jashtëm.
10	Sipërfaqet për sport dhe rekreacion	Sipërfaqe të rezervuara për zhvillimin e sporteve të ndryshme: tenis, futboll, basketboll, volejboll etj. Ofrimi i atraksioneve tjera: hiking, kalërim, bicklizim etj.
11	Porti	Porti do të jetë në funksion të ankorimit të jahteve luksoze
12	Heliport	Pista për ulje dhe ngritje të helikopterëve.
13	Akuapark	I brendshëm dhe I jashtëm, përfshirë hotele dhe qendër afaniste.
14	Tregu	Tregu i cili do të ofrojë prodhime bujqësore nga zona dhe prodhime tjera vendore.
15	Objekte Administrative, shërbimeve shëndetësore dhe të shërbimeve tjera	Banka, posta, administrata, ambulanta etj.
16	Objekte Edukative-Arsimore	Shkolla e hotelierisë dhe turizmit, institut për peshq dhe agrikulturë



mabetex group


Via Canton 7, CH-6900 Lugano-Paradiso

Tel. +41 (0)91 985 01 01

Fax +41 (0)91 993 06 36

info@mabetex.com

www.mabetex.com



KËRKESA PARAPRAKE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES

Aktualisht, shoqëria Mabetex group ka identifikuar në tërësi zonën bregdetare përgjatë bregdetit/gjirit të Divjakës, ndërmjet dy lumenjve Shkumbin dhe Seman për shtrirjen e projektit investues, duke mos përcaktuar ende ekzaktësisht sipërfaqet e tokës në të cilën do të zhvillohet ky projekt.

Arsyet që kanë diktuar mungesën e një përkufizimi dhe përcaktimi të saktë të shtrirjes sipërfaqësore të projektit tonë investues, ashtu sic jeni edhe Ju në dëjjeni në vijim të takimeve dhe komunikimeve tona të mëparshme, janë të lidhura kryesisht me verifikimet paraprake që janë duke zhvilluar institucionet kompetente të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

- Identifikimin e pronësisë së sipërfaqeve të tokës ndërmjet dy lumenjve Shkumbin dhe Seman (parcelat e tokës që janë në pronësi të shtetit Shqiptar dhe në pronësi të personave privatë);
- Identifikimin e parcelave të tokës të cilat mund të jenë dhënë me kontrata koncesionare, qiradhënie, në përdorim etj., nga Entet/Institucionet kompetente të shtetit Shqiptar subjekteve private;
- Identifikimin sipërfaqeve të tokës të disponueshme nga ana e shtetit Shqiptar, për zhvillimin e projekti investues të shoqërisë Mabetex, në vijën bregdetare ndërmjet dy lumenjve Shkumbin dhe Seman, duke përfshirë këtu edhe kufizimet e mundshme që mund të ekzistojnë për këtë qëllim.

Përsa mësipër, duke qenë se plotësimi i kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 13, "Paraqitja e projektit dhe dokumentacioni përkatës" të Ligjit nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", nga ana e shoqërisë Mabetex, është tërësisht i ndërvarur nga përcaktimi saktësisht dhe zyrtarisht nga ana e shtetit Shqiptar, i sipërfaqeve të tokës të disponueshme për zhvillimin e projektit investues,...

...lutemi identifikimin dhe përcjelljen në një kohë sa më të shkurtër të këtij informacioni paraprak, i cili është i domosdoshëm për ecurinë dhe vijueshmërinë e projektit investues të Shoqërisë Mabetex group.

Duke Ju falënderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm, dhe të sigurtë që kjo mbështetje dhe ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, me qëllimin dhe interesin e përpashkët të realizimit sa më shpejt të projektit investues, mbetemi në pritje të udhëzimeve Tuaja të mëtejshme,

Me Respekt,

Afrim Pacolli, President Mabetex Group.



mabetex group
Via Carrara 7, CH.6900 Lugano-Paroliso

Tel. +41 (0)91 995 01 01
Fax +41 (0)91 993 06 36

info@mabetex.com
www.mabetex.com